



Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 04/2011/KRPP

Pjesa 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të qartësohet dhe korrektohet keqkuptimi i shpeshtë në lidhje me Nenet 51 dhe 52 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 03/L-241 në lidhje me dallimet dhe përdorimin e drejtë te kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve të dhënies së kontratës.

Pjesa 2 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Pjesa 3 Përdorimi i kritereve të përzgjedhjes

Sipas Nenit 51 të LPP-së kriteret e përzgjedhjes duhet të theksohen në njoftimin për kontratë dhe të specifikohen në dosjen e tenderit. Qëllimi i kritereve të përzgjedhjes është që të sigurohet që operatorët ekonomik kanë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike për të përbushur kontratën.

Autoriteti Kontraktues i përcakton kërkesat e nevojshme në pajtueshmëri me Nenit 65-70 të LPP-së. Autoriteti Kontraktues gjithashtu vendoș për dokumentacionin e domosdoshëm për verifikimin e kërkesave të parashtruara. Këto kritere gjithashtu janë të lidhura ngushtë me aftësitë dhe kualifikimet e operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e përmendura përmes dorëzimit të dokumentacionit si dëshmi. Pasi që këto të janë kontrolluar nga Autoriteti Kontraktues do të vendoiset nëse operatori ekonomik përkatës kualifikohet apo diskualifikohet.

Nëse një operator ekonomik nuk i plotëson këto kushte, operatori ekonomik në fjalë nuk kualifikohet dhe në përputhje me këtë atij nuk duhet ti lejohet që të merr pjesë më tutje në tender. Operatori Ekonomik në fjalë duhet të refuzohet. Vetëm tenderët nga operatorët ekonomik të kualifikuar mund të merren në konsideratë gjatë procedurës së dhënies së kontratës.

Pjesa 4 Përdorimi i kritereve të dhënies së kontratës

Sipas Nenit 52 të LPP-së kriteret e dhënies duhet të specifikohen në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Kriteret e dhënies shërbejnë për qëllim të përcaktimit të operatorit ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët ose tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

Këto kritere duhet të jenë të lidhura drejt për së drejti me objektivin e aktivitetit të prokurimit, siç është përmendur në Neni 52.2 të LPP-së. Për më shumë, Neni 52.5 qartë deklaron se është obligim i Autoritetit Kontraktues që të bëjë dallimin e qartë në mes të kritereve të dhënies së kontratës dhe kritereve të përmendura në Pjesën 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Pjesa 5 Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues duhet të siguroj që kërkesat e LPP-së, veçanërisht Neni 51 dhe 52 janë plotësuar duke mos lejuar që kriteret e përzgjedhjes të përdorën si kriteri të dhënies së kontratës.

Kjo nënkuption se asnjë kriteri në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik nuk mund të përdorën si kriteri për dhënies së kontratës.

Pjesa 6 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Date 19.05.2011

Safet Hoxha,
Kryetari i KRPP-së Prishtinë,

